



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

RAPORTI I PUNËS SË AGJENCISË

PERIUDHA RAPORTUESE 23 QERSHOR - 31 DHJETOR

2011

Prishtinë,
mars, 2012

Përmbajtja e Raportit

1. Hyrje

2. Korniza ligjore

3. Përgjegjësitë dhe Autorizimet

- 3.1 Përgjegjësitë
- 3.2 Autorizimet
- 3.3 Misioni dhe vizioni
- 3.4 Aktet nënligjore

4. Shqetësimet e raportit të progresit 2011

5. Aktivitetet e Agjencisë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

- 5.1 Organizimi i agjencisë
- 5.2 Këshilla dhe opinione
- 5.3 Ankesa
- 5.4 Inspektimi dhe kontrolli
- 5.5 Harmonizimi i Legjislacionit
- 5.6 Informimi dhe Promovimi
- 5.7 Bashkëpunimi Ndërkombëtar
- 5.8 Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale
- 5.9 Regjistrimi i dosjeve dhe video regjistrimet
- 5.10 Transferimi i të dhënave
- 5.11 Buxheti

6. Vlerësimet e përgjithshme dhe rekomandimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale

1. Hyrje

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale, si pjesë e së drejtës të privatësisë, është e drejtë themelore në kuadër të drejtave të njeriut. E drejtë kjo e domosdoshme për funksionimin e një shoqërie demokratike. Për më tepër, kjo e drejtë mbrohet me kushtetutë dhe Ligjin për Mbrojtje të të Dhënave Personale. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës është autoriteti që zbaton këtë ligj.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative dhe telekomunikimit e ka bërë më të ndërlikuar procesin e mbrojtjes së të dhënave personale. Tani, me pajisjet e teknologjisë moderne, si kompjuterët, rrjetet e internetit, incizimet audio dhe video, etj., që janë shndërruar në mjetet kryesore për grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Ky zhvillim i teknologjisë, në njërin anë, bëri jetën tonë më të lehtë, por në anën tjetër ndikoi negativisht në privatësinë tonë.

Raporti të cilin e kemi formësuar dhe po e prezantojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës është obligim ligjor, të cilin Agjencia është e detyruar ta paraqesë në baza vjetore. Ky raport pune i Agjencisë mund t'ju shërbejë të gjitha palëve të interesuara për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 29 prill 2010 aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në bazë të këtij ligji, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit të Qeverisë, më 23 qershor 2011 aprovoi vendimin për caktimin e Këshillit Mbikëqyrës Shtetëror në përbërje nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë dhe atë: Ruzhdi Jashari, Mentor Hoxhaj, Ramadan Qehaja, Bekim Demiri dhe Aleksandar Spasic.

Formësimi i Agjencisë, në fakt, u karakterizua me mjaft vështirësi financiare, por edhe të moskuptimit të duhur të rolit dhe përgjegjësisë që ajo ka në shoqërinë tonë. Agjencia, edhe pse numerikisht e kufizuar dhe me vështirësi materiale-teknike, tani më është në rrugë të mbarë drejt formësimit dhe operacionalizimit të saj për kryerjen e detyrave dhe obligimeve që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Fatkeqësisht, duhet theksuar se vetëm një numër i vogël i zyrtarëve që punojnë në administratë publike apo në organizatat private kanë njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, shumica e qytetarëve janë pak të informuar për të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

Bazuar në gjendjen jo të mirë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të nevojës së zbatimit të ligjit, Agjencia në mënyrë të përsheptuar arriti që në këtë periudhë të shkurtër kohore të bëjë formësimin dhe deri diku funksionalizimin e saj për kryerjen e detyrave dhe obligimeve që burojnë nga ligji. Në përputhje me nevojën e informimit për detyrat dhe obligimet që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia arriti të realizojë shumë takime informuese me organet publike, organet private dhe shoqërinë civile. Gjithashtu, përmes prezencës në mjetet e informimit, është dhënë kontribut në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Korniza ligjore

Në Republikën e Kosovës e Drejta e Privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, dhe Marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare, Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe disa dispozita të Kodit Penal.

Kjo e drejtë, e garantuar me neni 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshinë respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu edhe zbatimi i drejtpërdrejt i të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ;

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës Aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172) i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelon institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22, pika 2 është ratifikuar Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj, ku me nenin 8 respektohet e drejta e privatësisë dhe jetës familjare.

Konventat dhe direktivat evropiane, të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë janë: Konventa 108/EC dhe protokollet shtesë (për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale), Direktiva 95/46/EC, Direktiva 2002/58/EC (te-privatësia dhe komunikimet elektronike), Direktiva 2006/24/EC. Konventat lartcekura ende nuk janë të ratifikuara nga ana e Kuvendit të Kosovës por që duhet të ratifikohen në të ardhmen.

Harmonizimi i legjislacionit me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale është obligim ligjorë si dhe standard evropian i cili do të jetë angazhim i përhershëm i Agjencisë në vitet në vijim.

3. Përgjegjësitë dhe Autorizimet

3.1 Përgjegjësitë

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale është institucion shtetëror i pavarur i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Agjencia kryesohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetëror, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe institucionet private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

Propozon dhe promovon përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave personale; Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia vendosë lidhur me ankesat e personave nëse ai ose ajo konsiderojnë se e drejta e tyre për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, dhe informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe masat e ndërmarra; Jep pëlqimin lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve si dhe krijon dhe mirëmbanë regjistrin e sistemit të dosjeve; Mbikëqyrë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për sigurimin e të dhënave personale; Kryen inspektime dhe kontrole për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale; Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave; Parashtron kërkesë te Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës; Përpilon planin vjetor të punës si dhe paraqet para Kuvendit raportin vjetor të punës në lidhje me zhvillimet, vlerësimet dhe rekomandimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të njëjtin e bën publik; Ja propozon Kuvendit buxhetin për nevojat vjetore të Agjencisë; Nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit.

3.2 Autorizimet

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Agjencia kryen inspektime dhe kontrole. Inspektimet dhe kontrollet realizohen vetëm nga mbikëqyrësit shtetërorë. Në këtë kuadër mbikëqyrësit shtetërorë kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij; kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogjet e sistemeve të dosjeve; kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale; kontrollojnë ndërtesën në të cilën të dhënat personale përpunohen dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik; verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim të sigurojnë të dhënat personale dhe zbatimin e tyre; kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontroleve të parapara me këtë ligj.

Nëse gjatë inspektimit dhe kontrollit, mbikëqyrësi vëren shkelje të këtij ligji ose të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ai ose ajo kanë të drejtë që

menjëherë të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose ajo i vënë re, në mënyrën dhe

brenda afatit të caktuar më parë nga ai ose ajo. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale në pajtim me ligjin; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publik ose privat, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin e tyre, klasifikimin dhe

bllokimin e të dhënave personale sa herë që ai ose ajo vjen në përfundim se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin/transferimin e të dhënave personale në vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj nëse ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me marrëveshjet ndërkombëtare; të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla; në rast të parregullsive ose mangësive kontrolluesi i të dhënave ose përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigjojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga Mbikëqyrësi për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.

Në rastin e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji nga ana e personave juridik dhe fizik, Agjencia mund të ndërmarrë masa ndëshkuese të cilat, varësisht nga shkelja, dënohen për kundërvajtje me gjobë prej 200€ deri më 10,000€.

Kundër vendimit përfundimtar të mbikëqyrësit nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Mbikëqyrësit janë të obliguar që të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të detyrave të tyre.

3.3 Misioni dhe Vizioni

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e ushtron veprimtarinë si një institucion publik, i pavarur, i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të cilitdo ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Në kuadër të zbatimit të ligjit, synonë dhe bënë hartimin e akteve nënligjore për plotësimin e kuadrit ligjor, ndërgjegjësimin e përpunuesve dhe kontrolluesve privat dhe publik lidhur me obligimet që dalin nga ligji gjatë përpunimit të të dhënave personale; bënë informimin e subjekteve të të dhënave lidhur me të drejtat e tyre; ngritjen e vetëdijes së qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë; regjistron të gjitha sistemet e dosjeve të kontrolluesve; shqyrton të gjitha ankesat dhe kërkesat; bënë: krijimin e listës së vendeve që kanë nivel të duhur për mbrojtjen e të dhënave personale; regjistrimin e të gjithë kontrolluesve që kanë të instaluar video-mbikëqyrje, si dhe përmes inspektimeve dhe kontrolleve bëhet mbikëqyrja dhe legjitimiteti i përpunimit të dhënave personale.

3.4 Aktet nënligjore

Me qëllim të zbatimit të ligjit dhe funksionalizim të agjencisë; janë themeluar grupe punuese për hartimin e udhëzimeve administrative dhe rregullores së punës:

1. Rregulloren e Punës;
2. Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
3. Udhëzimin Administrativ për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Media;
4. Udhëzimin Administrativ për Përpunimin e të Dhënave nga Institucionet Arsimore;
5. Udhëzimin Administrativ për Nxjerrjen e Kartelave Zyrtare për Mbikëqyrësit e Agjencisë;

Rregullorja e Punës, Udhëzimi Administrativ për Caktimin e Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave është aprovuar nga Këshilli, ndërsa udhëzimet tjera janë ende në hartim dhe procedur aprovuese. Planifikohet që në pjesën e parë të vitit 2012, me ndihmën edhe të ekspertëve nga projekti i TAIEX-it të përfundohen të gjitha udhëzimet administrative që janë të nevojshme për zbatimin e ligjit.

4. Shqetësimet e Raportit të Progresit 2011

Kur është fjala për Kosovën dhe synimet e saja drejt integritimeve evropiane, mbrojtja e të dhënave personale, përveç tjerash, ka rëndësi të posaçme. Të gjitha raportet e ndryshme ndërkombëtare, e në veçanti të Bashkimit Evropian, në mënyrë decisive kane potencuar nivelin e ulët të të arriturave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë kontekst edhe Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2011 thekson:

"Kosova ka bërë pak përparim në mbrojtjen e të dhënave personale. Në maj, Kuvendi ka miratuar pesë anëtarë të këshillit (shëfën e mbikëqyrësve kombëtarë dhe katër mbikëqyrësit kombëtarë) të agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale të cilët janë propozuar nga Qeveria, e cila është përcjellë me themelimin e Agjencisë në korrik. Vetëdijësimi i mbrojtjes së të dhënave mbetet shumë i ulët. Kapacitetet nga të gjitha institucionet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave kanë vazhduar të jenë shumë të kufizuara. Për shkak të mungesës së mekanizmave që rregullojnë përdorimin e të dhënave personale, procedura rishtazi e paraqitur për regjistrimin e SIM kartelave që përfshinë grumbullimin e të dhënave personale nga operatorët celularë, ngritë disa brenga.

Në përgjithësi, mungesa e mbrojtjes së të dhënave personale mbetet një çështje brengosëse. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëdha në këtë fushë".

Duke reflektuar nga konstatimi në raportin e progresit në lidhje me regjistrimin e sërishëm të SIM kartelave që përfshinë grumbullimin e të dhënave personale nga operatorët e telefonisë mobile, Agjencia, në dhjetor të viti 2011 ka krijuar komisionin e posaçëm me detyrë: **verifikimin e shkeljeve të mundshme nga operatorët e telefonisë mobile**. Pas takimeve me ART-në, dhe inspektimit të katër operatorëve mobil (Vala, Ipko, Dardafon.net /Z-mobile dhe d3-mobile) Agjencia konstatoi se: gjatë grumbullimit të të dhënave ka pasur parregullsi. Si rrjedhojë e gjendjes së konstatuar, Agjencia ka nxjerrë 10 vendime që urdhërojnë operatorët të mënjanojnë parregullsitë e konstatuara.

Në këtë periudhë raportuese duhet theksuar se përveç përzgjedhjes së pesë mbikëqyrësve, në fakt, filloi edhe operacionalizimi i Agjencisë, ku brengat dhe shqetësimet e raportit të progresit njëkohësisht janë edhe shqetësime dhe detyra të Agjencisë për periudhën vijuese.

5. Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

a. Organizimi i Agjencisë

Organet e Agjencisë janë **Këshilli** dhe **Departamentet**.

Këshilli

Agjencia kryesohet nga Këshilli pesë anëtarësh të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Këshilli përbëhet nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror dhe katër Mbikëqyrës Shtetëror, ku njëri prej tyre është Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror.

Departamentet

Departamentet mbështesin punën e Këshillit.

Për të kryer punë profesionale dhe administrative, fushëveprimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Agjencia punëson personel dhe organizon Departamente në këto dy fusha:

- Fusha e Administratës
- Fusha Profesionale - Operacionale

Personeli i punësuar është i obliguar që të mbrojë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të tyre.

Personeli i punësuar në Agjenci, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, duhet të jetë transparent, profesional, efikas dhe efektiv, i pavarur, i paanshëm dhe nuk mund ushtrojnë asnjë veprimtari politike.

Ne bazë të Buxhetit të ndarë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës , Agjencia ka të lejuar stafin prej njëzet zyrtarësh. Prej të cilave pesë janë të emëruar nga kuvendi. Ndërsa pjesa tjetër janë shërbyes civil.

Për shkak të mungesës së personelit dhe kohës së shkurtër, Agjencia ka transferuar disa zyrtarë nga institucionet tjera dhe ka bërë përgatitjet e nevojshme për hapjen e procedurave të regrutimit për pjesën tjetër të mbetur. Transferimi i zyrtarëve nga institucionet tjera shtetërore është bërë me qëllim të funksionalizimit sa më të shpejtë të Agjencisë. Transferimet janë kryer në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

Përkundër transferimeve, kapacitetet njerëzore kanë qenë të pamjaftueshme në relacionet me nevojat e Agjencisë. Për këtë, Agjencia ka kërkuar ndihmë nga Kuvendi i Kosovës Zyra e Kryeministrit-ZKM,dhe Ministria e Administratës Publike-MAP. Me që rastë Agjencia ka bërë marrëveshje me Administratën e Kuvendit për realizimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave, si dhe mbështetjeve tjera logjistike. Ndërsa nga ZKM dhe MAP kemi pranuar ndihmesa në ngritje të kapaciteteve në fushën e TI-së dhe telekomunikimit.

Numri i vogël i personelit të lejuar, paraqet sfidë në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Kjo është potencuar edhe nga institucionet e Bashkimit Europian të cilat përcjellin zhvillimet në fushën e liberalizimit të vizave të cilat kanë nxjerr tri shqetësime serioze sa i përket funksionalizimit të plotë :

- Numri i vogël i stafit mbështetës i lejuar
- Buxheti
- Objekti – hapësirat për punë

b. Këshilla dhe Opinione

Agjencia jep këshilla dhe opinione institucioneve publike dhe private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale. Gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka dhënë një opinion dhe një këshillë, për;

- Doganat e Republikës së Kosovës

Agjencia ka pranuar kërkesë për opinion nga ana e Doganave të Kosovës, lidhur me iniciative të Doganës së Republikës së Maqedonisë, për krijimin e një sistemi për shkëmbimin e të dhënave lidhur me deklaratimet monetare që bëhen në vendkalimet kufitare në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Agjencia ka analizuar informatat e ofruara nga Dogana e Kosovës dhe ka dhënë opinionin që përpunimi i të dhënave të bazohet në parimet e mëposhtme:

- Transferimi i të dhënave duhet të ketë bazë ligjore;
- Sasia e të dhënave të transferuara duhet të jetë minimale, që do të thotë, të arrihet qëllimi i transferimit me sa më pak të dhëna;
- Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem të mos tejkaloj kohën e nevojshme për arritjen e qëllimit;
- Këshilla ART-së lidhur me harmonizimin e rregullores me ligjin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit -ART-së dhe Ligjin 03/1-172 .

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas inspektimit të Operatoreve të Telefonisë Mobile dhe analizimit të kuadrit ligjor për regjistrimin e abonentëve të telefonisë mobile, ka konstatuar që një akt nënligjor nuk është në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Lidhur me këtë të gjetur; Agjencia ka këshilluar ART-në për harmonizimin e aktit në fjalë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. ART ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit për harmonizimin e legjislacionit dhe promovimin e mbrojtjes së të dhënave në fushën e telekomunikimit duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Agjencia mirëpret çdo kërkesë për këshilla dhe opinione nga institucionet publike ose private me qëllim të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke synuar arritjen e standardeve evropiane në fushën e mbrojtjes së të drejtës së privatësisë në lidhje me të dhënat personale, e drejtë kjo, e garantuar me Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut, direktivave dhe konventat evropiane.

c. Ankesat

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person i cili konsideron që i është shkelur e drejta e tij ose e sajë në privatësi në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtrij ankesë në Agjenci. Ankesat mund të parashtrihen gojarisht përmes telefonit, me shkrim ose me mjete elektronike përmes e-mailit. Pas shqyrtimit të ankesës, Agjencia informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe veprimet e ndërmarra.

Në vitin për të cilin raportojmë, nuk kemi pasur ankesa nga ana e qytetarëve. Njëra nga arsyet për të cilën mendojmë se nuk ka pasur ankesa është ngaqë vetëm në muajin nëntor kemi arritur të sigurojmë objekt për hapësira pune/zyrë. Ndër arsyet për mosparaqitje të ankesave nga qytetarët ka qenë edhe koha e shkurtë për informimin e qytetarëve për këtë të drejtë të tyre.

Në vitet në vazhdim, informimi i qytetarëve do të jetë një sfidë dhe angazhim permanent për të cilin edhe në planin e punës/2012 janë paraparë disa aktivitete. Aktivitetet e parapara me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave të qytetarëve për mbrojtjet e të dhënave personale dhe privatësisë, do të jenë mjaft sfiduese për shkak të kufizimeve buxhetore.

d. Inspektimi dhe Kontrolli

Mbikëqyrja e përpunimit të ligjshëm e të dhënave bëhet përmes inspektimeve dhe kontrolleve.

Me qëllim të zbatimit të ligjit, Agjencia ka të drejtë të kontrollojë, konfiskojë, verifikojë dokumente apo pajisje. Në rast të shkeljeve të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale apo të ndonjë ligji që rregullon përpunimin e të dhënave personale, Agjencia ka të drejtë të urdhërojë eliminimin e parregullsive, të ndalojë përpunimin e metutjeshëm, si dhe të paralajmërojë apo të këshillojë nëse shkeljet janë të vogla. Nëse institucioni nuk përfillë vendimet e Agjencisë, mund të merren masa ndëshkuese.

Në vitin 2011 kemi pasur katër inspektime, të cilat janë realizuar pas vërejtjeve të raportit të progresit lidhur me regjistrimin e sërishëm të SIM kartelave nga ana e operatorëve mobil.

Inspektimi pati si objekt ligjshmërinë e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave të klientëve Para-pagues dhe pas-pagues – me kontratë (pre-paid dhe post-paid), sigurinë fizike të dosjeve të klientëve, sigurinë e dhomës së serverëve ku ruhen të dhënat në formë elektronike si dhe siguria e kontrollit të qasjes në objektet dhe sistemet softuerike.

- Inspektimi në Operatorin e Telefonisë mobile VALA

Gjatë inspektimit fizik dhe shqyrtimit të bazës ligjore që shërbente për grumbullimin e të dhënave, rezultoi që objekti ku ruheshin dosjet e klientëve nuk kishte siguri të mjaftueshme, për klientët para-pagues dhe pas-pagues – me kontratë
Gjithashtu për regjistrimin e abonentëve kërkohet:

- Kopja e dokumenteve identifikuese (letërnjoftimit, pasaportës, etj).
- Gjendja e llogarisë bankare (qarkullimi i tre muajve të fundit).
- Fatura e energjisë elektrike.

Të gjitha kopjet e dokumenteve të lartëcekura kopjoheshin dhe ruheshin në dosjet e klientëve.

Pas shqyrtimit të bazës ligjore është konstatuar se operatorët kanë tejkaluar qëllimin e grumbullimit të të dhënave, pasi që kopjet e dokumenteve të lartcekura mund të shërbejnë vetëm për verifikim të të dhënave gjatë regjistrimit të klientëve dhe jo edhe të ruajtjes së dokumenteve.

Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të legjislacionit në fuqi, që rregullon grumbullimin e të dhënave gjatë regjistrimit të klientëve të operatorëve mobil, Agjencia erdhi deri te përfundimi se kjo mënyrë e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë është e paligjshme, dhe e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në lidhje me shkeljet e evidentuara më lartë, Agjencia mori këto vendime:

- Vendimin për të urdhëruar që në afat prej tetë ditësh të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e dosjeve fizike të klientëve në harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Vendimin për të urdhëruar që të bëhet asgjësimi i të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara pas verifikimit të dhënave, si dhe të asgjësohen dokumentet e klientëve të cilët nuk janë aktivë dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi të kenë përmbyllur procedurat gjyqësore. Ky asgjësim të bëhet deri më 15.02.2012.
- Vendimin për të urdhëruar që pas verifikimit të nevojshëm të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit, të mos ndalen/mbahen fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të dhëna personale. Gjithashtu, është caktuar një afat për ndalimin e depozitimit, i cili fillon nga data 01. 01. 2012.
- Këshillën që t'u përmbahen obligimeve/detyrimeve, që dalin nga neni 16 pika 2 e Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili specifikon që çdo përpunues i të dhënave duhet të përshkruajë në aktet e brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojë në formë të shkruar personat kompetentë që janë përgjegjës për sistemimin e dosjeve dhe personat të cilët, për shkak të natyrës së punës së tyre, duhet të përpunojnë të dhënat personale.
- Inspektimi në Operatorin e Telefonisë mobile IPKO

Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të legjislacionit në fuqi, që rregullon grumbullimin e të dhënave gjatë regjistrimit të klientëve të operatorëve mobil, Agjencia erdhi deri te përfundimi se kjo mënyrë e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë është e paligjshme, dhe e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në lidhje me shkeljet e evidentuara, Agjencia mori këto vendime për Operatorin e Telefonisë mobile IPKO:

- Vendimin për të urdhëruar që të bëhet asgjësimi i të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara pas verifikimit të të dhënave, si dhe të asgjësohen dokumentet e klientëve të cilët nuk janë aktivë dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi të ketë përmbyllur procedurat gjyqësore. Ky asgjësim të bëhet deri më 15.02.2012.
- Vendimin për të urdhëruar që pas verifikimit të nevojshëm të të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit, të mos ndalen/mbahen fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të

dhëna personale. Gjithashtu, është caktuar një afat për ndalimin e depozitimit, i cili fillon nga data 01. 01. 2012.

- Vendimi për mos ndërhyrje ne formularin për regjistrimin e abonentëve para-pagues.
- Inspektimi në Operatorin e Telefonisë mobile Dardafon.net / Z Mobile

Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të legjislacionit ne fuqi, që rregullon grumbullimin e të dhënave gjatë regjistrimit të klientëve të operatorëve mobil, Agjencia erdhi deri te përfundimi se kjo mënyrë e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë është e paligjshme, dhe e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në lidhje me shkeljet e evidentuara, Agjencia mori këto vendime për Operatorin e Telefonisë mobile Z mobile:

- Vendimin për të urdhëruar që të bëhet asgjësimi i të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara pas verifikimit të të dhënave, si dhe të asgjësohen dokumentet e klientëve të cilët nuk janë aktivë dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi të ken përmbyllur procedurat gjyqësore. Ky asgjësim të bëhet deri më 15.02.2012.
- Vendimin për të urdhëruar që pas verifikimit të nevojshëm të të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit, të mos ndalen/mbahen fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të dhëna personale. Gjithashtu, është caktuar një afat për ndalimin e depozitimit, i cili fillon nga data 01. 01. 2012.
- Inspektimi në Operatorin e Telefonisë mobile D3 Mobile

Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të legjislacionit në fuqi, që rregullon grumbullimin e të dhënave gjatë regjistrimit të klientëve, të operatorëve mobil, Agjencia erdhi deri te përfundimi se kjo mënyrë e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë është e paligjshme, dhe e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në lidhje me shkeljet e evidentuara, Agjencia mori këto vendime për Operatorin e Telefonisë mobile D3 mobile:

- Vendimin për të urdhëruar që të bëhet asgjësimi i të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara pas verifikimit të të dhënave, si dhe të asgjësohen dokumentet e klientëve të cilët nuk janë aktivë dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi të ketë përmbyllur procedurat gjyqësore. Ky asgjësim të bëhet deri më 15.02.2012.
- Vendimin për të urdhëruar që pas verifikimit të nevojshëm të të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit, të mos ndalen/mbahen fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të dhëna personale. Gjithashtu, është caktuar një afat për ndalimin e depozitimit, i cili fillon nga data 01. 01. 2012.

Vlen të theksohet se edhe pse afatet të cilat janë dhënë për realizimin e vendimeve tejkalojnë vitin 2011, operatorët e të telefonisë mobile janë në vijën e veprimit të plotë për zbatimin e vendimeve të ndërmarra nga AGJENCIA SHITËTORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

5.5 Harmonizimi i Legjislacionit

Harmonizimi dhe përafrimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së (Acquis Communautaire) në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë ka qenë dhe është një ndër prioritetet e Agjencisë.

Në kuadër të kësaj Agjencia ka bërë vlerësim preliminar, ku del se rreth 78 ligje të aprovuara deri më 31 dhjetor 2011 duhet rishikuar dhe vlerësuar nëse këto ligje janë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për shkak të krijimit të vonshëm, në këtë rast edhe pamundësisë së rekrutimit të stafit profesional, ky aktivitet është paraparë në planin e punës për vitin 2012. Një aktivitet i tillë do të realizohet edhe me ndihmën e ekspertëve që do të vinë gjatë vitit 2012 në kuadër të projektit të TAIEX-it.

Në sferën e sundimit të ligjit Agjencia zënë vend të rëndësishëm në jetën institucionale dhe shtetërore dhe në këtë drejtim Agjencia suksesëshëm është përfshi në

- GRUPIN PUNUES PER LIBERALIZIMIN E VIZAVE NË KOSOVË DHE NË
- ILEK/MEKANIZËM KY PER SUNDIMIN E LIGJIT I NGRITUR GJAT VITIT 2011

5.6 Informimi dhe Promovimi

Informimi i publikut për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave si dhe promovimi i të drejtës themelore për mbrojtjen e të dhënave personale është një ndër prioritetet dhe njëkohësisht sfidë e Agjencisë.

Në kuadër të kësaj, me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave dhe obligimeve që burojnë nga ligji, Agjencia ka organizuar mbi 80 takime me përfaqësuesit e organeve publike edhe private. Gjatë këtyre takimeve është vënë re nevoja dhe domosdoshmëria e ngritjes së kapaciteteve njerëzore brenda këtyre organeve, të cilat do të ishin përgjegjëse për informimin, promovimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të organit përkatës. Kjo përgjegjësi buron nga ligji, prandaj Agjencia ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave.

Në gusht të viti 2011, me qëllim të promovimit të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka organizuar në bashkëpunim me OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, konferencën me titull “Mbrojtja e të Dhënave Personale në Kosovë”, ku pjesëmarrës kanë qenë shoqëria civile, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe vendëse.

Me qëllim që qytetarët të jenë të informuar me të drejtat e tyre, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Agjencia, gjatë muajit nëntor-dhjetor ka hartuar dhe shpërndarë dy fletëpalosje, me të cilat është synuar që qytetari të informohet lidhur me detyrat dhe obligimet e Agjencisë, si dhe me të drejtat e qytetarit që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur për Media, Agjencia ka organizuar punëtorin me temën “Media dhe Privatësia” me qëllim të promovimit të privatësisë gjatë përpunimit të dhënave personale nga ana e mediave.

Me qëllim që qytetarët dhe publiku në përgjithësi, të informohen dhe ankohen më lehtë, Agjencia, në muajin dhjetor ka marrë hapat e duhur për krijimin e web faqes së saj.

Web faqja zyrtare e Agjencisë është www.amdp-rks.org, ndërsa adresa zyrtare informuese është info.admp@rks-gov.net.

Web faqja, në të ardhmen e afërt do të jetë funksionale dhe do të pasurohet dhe freskohet me të dhëna. Njëkohësisht vazhdojnë përpjekjet që të ngritet cilësia, dhe kualiteti i kontakteve me qytetarët të cilët më lehtë mund të kontaktojnë me Agjencinë.

Agjencia mbetet e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të organeve publike dhe private, gjithashtu bashkëpunimi me shoqërinë civile është vlerësuar si shumë i frytshëm, i cili do të forcohet vit pas viti.

5.6 Bashkëpunim Ndërkombëtar

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në objektivat e vitit 2011 mes tjerash në fokus, ka qenë vënia e kontakteve dhe bashkëpunimit, fillimisht me autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale në regjion, si dhe me autoritetin qendror për mbrojtjen e të dhënave personale në Bruksel.

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka zhvilluar vizita me autoritetet në vijim:

- Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Shqipërisë;
- Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (tani Drejtoria për Mbrojtjen e Privatësisë) në Republikën e Maqedonisë;
- Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Malit të Zi;
- Komisionerin e Informacionit të Republikës së Sllovenisë;
- Komisionerin për Mbrojtjen e Privatësisë të Belgjikës;

Në saje të vizitave zyrtare të realizuara me qëllim të vënies së kontakteve të para dhe informimit rreth fushëveprimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë vizituar këto institucione:

- Ambasada e Republikës së Kosovës në Tiranë;
- Ambasada e Republikës së Kosovës në Bruksel;
- Ambasada e Republikës së Kosovës në Bernë;
- Ambasada e Republikës së Kosovës në Lublanë;
- Ambasada e Republikës së Kosovës në Shkup;

Agjencia, gjithashtu ka iniciuar dhe ka realizuar vizita në disa prej institucioneve relevante evropiane, me qëllim të njoftimit dhe nismave të para për një bashkëpunim më të ngushtë me karakter bashkëveprimi mes Agjencisë dhe institucioneve të poshtëshënuara, nga të cilat është kërkuar mbështetje për funksionalizimin më të shpejtë të Agjencisë, por edhe për ndihmën rreth anëtarësimit të Agjencisë në

organizmat përkatës evropianë. Në vijim po përmendim institucionet evropiane të vizituara nga Agjencia:

➤ Komisionin Evropian:

- Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim, ku është diskutuar lidhur me kornizën ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme;
- Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me të cilin është biseduar lidhur me sfidat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe praktikat më të mira evropiane.
- Drejtoratin e Përgjithshëm për Drejtësi, ku është biseduar lidhur me harmonizimin e legjislacionit vendor me atë evropian në fushën e mbrojtjes së drejtave dhe lirive të njeriut, respektivisht në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

➤ Këshillin e Evropës:

- Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit,
- Zyra për Mbrojtjen e Informacionit, ku është diskutuar lidhur me mbrojtjen e informacionit, mundësisë së transferimit të sigurtë të informacioneve.

➤ Parlamentin Evropian:

- Komiteti për të Drejtat Civile, ku përfaqësuesit e Agjencisë janë njoftuar lidhur me ndryshimet në legjislacionin evropian, të cilat janë duke u bërë me qëllim të forcimit të autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe direktivën e re për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në kuadër të të arriturave nga vizitat e lartpërmendura, më poshtë po përmendim memorandumet e bashkëpunimit të lidhura me organizatat homologe të këtyre vendeve:

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Maqedoninë, gjegjësisht me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Shqipërinë, respektivisht me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Si dhe janë pergaditur dhe jane vene Kontakte pune per realizim te marreveshjeve edhe me Sllovenine dhe me Malin e Zi, te cilat marrëveshje pritet të firmosen gjatë vitit në vijim.

Memorandumet e lartcekura parashohin arritjen e këtyre objektivave të përbashkët:

- Zhvillimin e legjislacionit;
- Bashkëpunimin me aktorë ndërkombëtarë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje të harmonizuar të problemeve të ndryshme;
- Shkëmbimin e përvojës në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike

- Aplikimi me Projektet te financuara nga Bashkimi Evropian;
- Shkëmbimin e informacionit në dispozicion të publikut në lidhje me standardet e reja evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Vizita dhe shkëmbimin e ekspertëve me qëllim të studimit të tipareve të funksionimit të sistemit institucional të mbrojtjes së të dhënave personale në shtetet e palëve;
- Trajnimin dhe pjesëmarrjen në tryeza të rrumbullakëta;

Agjencia ka pranuar ftesa në dy konferenca regjionale, në të cilat ka marrë pjesë aktive, si:

- Konferenca në Shkup me temën “Strategjia Regjionale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”; dhe
- Konferenca në Tiranë me temën: “Mbrojtja e të Dhënave Personale në Sektorin e Gjqësisë dhe Policisë”.

Vlenë të theksohet se që të dy konferencat kanë qenë pjesë e projekteve mbështetëse IPA për autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale të këtyre dy shteteve. Pjesëmarrja ka qenë kryesisht regjionale, por ka pasur edhe përfaqësues të autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave të shteteve më të largëta, siç është Ukraina, Sllovakia etj. si dhe të Evropës Qendrore, si Hungaria.

5.7 Caktim i Zyrtarit Mbrojtës

Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale është një obligim ligjor. Zyrtari mbrojtës i të dhënave në përgjithësi ka detyra të rëndësishme që kanë të bëjnë me këshillimin e institucionit ku ai vepron lidhur me obligimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave si dhe të shërbejë si person kontaktues në mes të Agjencisë dhe institucionit publik apo privat që përpunon të dhëna personale.

Në këtë drejtim, Agjencia ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili, në mënyrë të detajuar përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit, si dhe cakton kriteret bazë për domosdoshmërinë e caktimit të zyrtarit mbrojtës.

Në mënyrë që ti njoftojë me domosdoshmërinë dhe afatin e caktimit të zyrtarit mbrojtës, Agjencia u ka dërguar shkresa institucioneve publike si dhe ka bërë njoftimin përmes medimeve për institucionet private dhe publike.

Këtij obligimi ligjor i është përgjigjur një pjesë e konsiderueshme e institucioneve publike. Mendojmë që në vitin vijues ky proces do të përmbyllet.

5.7 Regjistri i Dosjeve dhe Regjistri i Video-Incizimeve

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia duhet të krijojë dhe mirëmbajë regjistrin e sistemit të dosjeve. Ky regjistër elektronik do të përmbajë listën e sistemeve të dosjeve që kanë organet publike dhe private (kontrolluesi) dhe ka për qëllim që subjekti i të dhënave të informohet se cilat të dhëna kontrolluesi mund t'i përpunojë dhe për cilin qëllim.

Duke pasur parasysh që për fillimin e procesit të regjistrimit të sistemit të dosjeve kërkohen disa parakushte, për shkak të kohës së shkurtë, regjistrimi nuk ka mundur të fillojë gjatë vitit 2011. Agjencia ka marrë vendim që regjistrimi të fillojë në vitin 2012, pasi që duhet të plotësuar kushte paraprake në mënyrë që të bëhet një regjistrim cilësor.

Në planin e punës për vitin 2012 është paraparë që të krijohet regjistri elektronik i sistemit të dosjeve, nxjerrja e udhëzimit administrativ për regjistrin dhe në tre-mujorshin e dytë të vitit 2012 të fillojë me regjistrimin e sistemit të dosjeve.

Agjencia do të krijojë edhe regjistrin e video-incizimeve. Ky regjistër do të përmbajë listën e organeve publike dhe private që posedojnë video-regjistrim.

Po ashtu, regjistri elektronik i video-incizimeve është planifikuar që të realizohet në pjesën e dytë të vitit 2012.

5.8 Transferimi i të Dhënave

Transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose do të përpunohen në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm nëse këto vende sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Agjencia, përmes një vendimi formal, nxjerr listën e shteteve apo organizatave që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Për të gjitha ato shtete apo organizata ndërkombëtare, të cilat nuk sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave, institucioni publik apo privat që dëshiron të bëjë transferimin e të dhënave, duhet të ndjekë procedurat e marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Në vitin 2011 nuk kemi marrë vendim për nxjerrjen e listës për vendet apo organizatat ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave. Kjo, për arsye të kohës së shkurtër të veprimit të Agjencisë, kohë e cila nevojitet për krijim të një liste të saktë të këtyre vendeve.

Po ashtu, nuk kemi pasur kërkesa për ndonjë autorizim të ndonjë transferimi të dhënave.

Në planin e punës për vitin e ardhshëm është paraparë krijimi i listës si dhe informimi i organeve publike dhe private që për të gjitha transferimet që dëshirojnë të bëjnë dhe që nuk janë në listë të aprovuar nga Agjencia duhet të kërkohet autorizim në të kundërtën do të pasojnë ndëshkimet sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5.9 Buxheti

Agjencia Shtetërore ka filluar punën me 24.06.2011 dhe me datë 04.07.2011 ka bërë kërkesë për buxhet, e cila kërkesë është mbështet pjesërisht dhe është dhënë rekomandimi nga Komisioni për Buxhet i Kuvendit të Republikës së Kosovës me datën 29.08.2011.

Bazuar në rekomandimin e Komisionit të Buxhetit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr vendim për ndarje buxhetore në shumë prej 189,786.00 € me datën 13.10.2011.

Me datën 21.10.2011 Ministria e Financave ka bërë alokimin e mjeteve buxhetore ne kodet e Agjencisë konform vendimit të Qeverisë dhe buxheti ka filluar të shpenzohet nga data 01.11.2011.

Buxheti i aprovuar për shkak të vonesës së lëshimit në kode buxhetore, periudhës së shkurtë kohore deri në përfundim të vitit fiskal, mungesës së personelit të nevojshëm, ka shkaktuar mosrealizim të procedurave dhe mbetje buxhetore prej 55,095.28 €.

Buxheti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të dhënave Personale për vitin 2011 ishte 189,786.00 € i ndarë në kategoritë kryesore si në vijim:

Tabela 1.1 Buxheti i ASHMDHP-së nga muaji tetor i vitit 2011

Përshkrimi	Shuma €
Paga dhe mëditje	70,716.00
Mallra dhe shërbime	86,900.00
Shpenzime komunale	2,170.00
Pasuritë Jofinanciare	30,000.00
Total	189,786.00

Sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës me datën 13.10.2011 nr. 08/42 është ndarë buxheti i ASHMDHP-së në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe po ashtu më pas në kategorinë për mallra dhe shërbime është bërë shkurtim i buxhetit me datë 13.11.2011 prej **4820 euro** ku edhe janë të paraqitura si të **pa nën-alokuara** në **tablën 1.8**, i cili shkurtim ka shkaktuar pamundësi për zotim (data 15.11.2011), bazuar në planin e nevojave bërë në tre mujorin e fundit të vitit fiskal 2011.

Tabela 1.2 Buxheti i ASHMDHP-së pas shkurtimit buxhetor (sipas Vendimit të Qeverisë).

Përshkrimi	Shuma €
Paga dhe mëditje	70,716.00
Mallra dhe shërbime	82,616.00
Shpenzime komunale	2,170.00
Pasuritë Jofinanciare	30,000.00
Total	185,502.00

Shpenzimet buxhetore

Financimi i aktiviteteve të ASHMDHP-së në gjashtë (6) mujorin 2011 sipas klasifikimeve ekonomike është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Janë shpenzuar EUR 134,456.10 si në vijim:

Tabela 1.3 Buxheti i shpenzuar

Përshkrimi	Shuma €
Paga dhe mëditje	55,684.24
Mallra dhe shërbime	77,691.02
Shpenzime komunale	1,080.84
Pasuritë Jofinanciare	-
Total	134,456.10

Sipas kategorive ekonomike, shkalla e shpenzimeve buxhetore është e paraqitur në përqindje (%).

Tabela 1.4 Shpenzimet buxhetore të shprehura në %

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në %
Paga dhe mëditje	70,716.00	55,684.24	79%
Mallra dhe shërbime	86,900.00	77,691.02	89%
Shpenzime komunale	2,170.00	1,080.84	56%
Pasuritë Jofinanciare (kapitale)	30,000.00	-	0
Total	189,786.00	134,456.10	71%

Tabelat në vazhdim pasqyrojnë shpenzimet e ASHMDHP-së sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tabela 1.5 Pagat dhe mëditjet (personeli dhe Këshilli i ASHMDHP-së)

Paga dhe mëditjet	Shuma €
Paga neto	46,198.42
Tatim i ndalur në të ardhura personale	4,182.54
Kontribute pensionale të punëdhënësit	2,651.64
Kontribute pensionale të të punësuarve	2,651.64
Gjithsej paga dhe mëditje	55,684.24

Tabela 1.6 Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shuma €
Shpenzimet e udhëtimit	9,410.00
Shërbimet e telekomunikimit	2,500.00
Shpenzimet për shërbime	9,679.00
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	31,929.40
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro	-
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	9,869.00
Derivatet dhe lëndët djegëse	-
Shërbimet financiare	-
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	-
Mungesa në arkë	-
Mirëmbajtja	1,014.00
Qiraja	9,750.00
Shpenzimet e marketingut	-
Shpenzimet e përfaqësimit	3,538.40
Gjithsej mallra dhe shërbime	77,691.02

Tabela 1.7 Shpenzimet komunale

Përshkrimi	Shuma
Rryma	775.27
Uji	22.79
Shpenzime të telefonisë fikse	283.78
Gjithsej shpenzime komunale	1,081.84

Duhet theksuar që të gjitha procedurat e prokurimit janë kryer duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore të kuvendit, në bazë të marrëveshjes në mes të Agjencisë sonë dhe Kuvendit të Kosovës.

1. Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Periudha kohore e raportimit për punën e Agjencisë është e shkurtër për një vlerësim të përgjithshëm dhe të hollësishëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Përkundur sfidave të kohës dhe buxhetit, Agjencia ka realizuar rreth 100 takime informuese, pas të cilave mund të konstatojmë se mbrojtja e të dhënave personale nuk është në nivelin e kënaqshme. Një numër shumë i vogël i nëpunësve në sektorin publik dhe privat kanë njohuri të nevojshme dhe të domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave personale, edhe pse të njëjtit janë përpunues të këtyre të dhënave. Fatkeqësisht, njohurit e qytetarëve në këtë fushë janë edhe më të pakta. Shumë pak prej tyre dinë që janë pronarë të të dhënave të tyre dhe që duhet të jenë të informuar se si përpunohen të dhënat personale. Kjo vjen edhe si rrjedhojë e faktit që Republika e Kosovës, e fundit në rajon, ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka themeluar autoritetin përgjegjës. Këto vonesa në aprovimin e ligjit dhe themelimin e Agjencisë, ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë që informimi i qytetarëve për të drejtat e tyre në këtë fushë të jetë shumë i vogël. Po ashtu, kjo ndikoi edhe në mos njoftimin e institucioneve publike dhe private për obligimet që ato kanë gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Është e dukshme që në ditët e sotme, të dhënat personale kanë një përdorim të lartë. Këtë përdorim të lartë e ka mundësuar teknologjia e informacionit dhe e telekomunikimit (TIK), e cila ka bërë të lehtë jetën e qytetarëve, por në anën tjetër e ka bërë të lehtë edhe abuzimin me këto të dhëna. Përdorimi i madh dhe jo i drejtë i rrjeteve sociale ka bërë që shpesh jeta jonë private të bëhet publike. Andaj informimi i qytetarëve për të drejtat e tyre si dhe për të dhënat personale është e rëndësishëm për të gjithë.

Gjithashtu edhe video incizimi si pjesë e zhvillimeve të TIK-ut, ka filluar të përdoret gjerësisht. Fillimisht, në institucionet publike dhe private tani edhe në hapësirat publike; si rrugët; parqet; etj. Shumica e këtyre video incizimeve janë në kundërshtim me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ashtu siç e kemi theksuar me lartë, transferimi i të dhënave, si brenda institucioneve të brendshme, po ashtu edhe me shtetet dhe institucionet e jashtme, realizohet pa ndonjë kriter duke mos respektuar dispozitat e parapara për transferim, në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu, shumica e institucioneve publike që kanë sisteme të të dhënave dhe që mirëmbajtjen dhe përpunimin e të dhënave e kanë të kontraktuar, nuk kanë marrëveshje për të drejtat dhe obligimet si dhe procedurat e përmbylljes së kontratës në lidhje me mbrojtjen e të dhënave. Nuk kanë kontrata të veçanta me përpunuesit e të dhënave (administratorët e bazave, etj) për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe procedurat e ndërprerjes së kontratës.

Legjislacioni në fusha të ndryshme (telekomunikacion, shëndetësi, arsim, etj) nuk është i harmonizuar me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi që një pjesë e këtyre ligjeve janë nxjerrë para prillit 2010. Por edhe pas miratimit të Ligjit, disa nga ligjet e reja të aprovuar nuk janë në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e të Dhënave Personale. Andaj rekomandojmë, propozuesit dhe aprovuesit e ligjeve dhe akteve nënligjore, gjatë hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të konsultojnë Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qëllim që aktet e miratuara të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kuvendit të Kosovës i rekomandojmë ratifikimin e Konventave të BE-së dhe nxjerrjen e ligjeve në fushatë e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe lirinë e informacionit në bazë të Direktivave të BE-së.

Mos aprovimi i Konventave të theksuara pamundëson anëtarësimin e Agjencisë tonë në organizmat European për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjithashtu është e pamundur që Republika e Kosovës të vlerësohet si Shtet që ofron nivelin e duhur për mbrojtjen e të dhënave personale. Ngase parakushtet bazë që një shtet të vlerësohet që ofron nivelin e duhur të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale janë:

- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Autoriteti i pavarur dhe funksional për mbrojtjen e të dhënave personale
- Konventa 108 BE e ratifikuar